



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0354
Data e Vendimit: 08.06.2026

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Astraplan SH.P.K. kundër njoftimit të AK-së për aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i Stacionit Policor Veri në Prishtinë” me numër të prokurimit 214/30400-26-1946-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Policia e Kosovës, Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, me datën: 08.06.2026, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si parakohshme, ankesa e OE “Astraplan SH.P.K me nr. të protokollit 0354/2026, e datës 02.06.2026, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i Stacionit Policor Veri në Prishtinë” me numër të prokurimit 214/30400-26-1946-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Policia e Kosovës, në cilësi të AK-së.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues- Policia e Kosovës që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit si në pikën I të dispozitivit, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 02.06.2026, ka pranuar ankesën e OE “Astraplan SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i Stacionit Policor Veri në Prishtinë” me numër të prokurimit 214/30400-26-1946-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Policia e Kosovës në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Me 10.04.2026, Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë ku hapja e ofertave e parashikuar me B05 ka qenë e planifikuar të bëhet më datën 02.06.2026.

Operatori Ekonomik "Astraplan SH.P.K, me datën 02.06.2026 ka parashtruar ankesë në OSHP me numër të protokollit 2026/0354.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit si në dispozitiv të këtij vendimi, me datën me 10.04.2026, është publikuar njoftimi për kontratë ku hapja e ofertave e parashikuar me B05 ka qenë e planifikuar të bëhet më datën 02.06.2026.

OE "Astraplan SH.P.K ka parashtruar ka parashtruar drejtpërsëdrejti Ankesë në OSHP me dt. 02/06/2026 (20:34) që i bie të bartët për dt. 03/06/2026, pa ju drejtuar paraprakisht AK-së me kërkesë për Rishqyrtim duke vepruar në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së dhe nenin 64 të RRPP-së.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në këtë procedurë prokurimi nga zyra e pranimit në OSHP, konstatohet se operatori ekonomik ka parashtruar ankesë të parakohshme për faktin se sipas nenit 109 të LPP-së operatori ekonomik mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së vetëm pas parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim në Autoritet Kontraktues.

Sipas nenit 109 të LPP-së kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së, pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Po ashtu, edhe me nenin 64 par 1 në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcaktohet se: Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të nxjerrë nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-se.

Po ashtu Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas të gjitha fakteve të analizuara sqaron se sipas nenit 111 paragrafi 1. 10 të Ligjit për Prokurim Publik çdo palë e interesuar mund të dorëzojë një ankesë në OSHP nëse ankesa e tillë ka dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit, të përmendur në nenin 118 të këtij ligji.

Poashtu sipas nenit 118 paragrafi 1 dhe 2 i LPP-së thuhet: "1. *Ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP vlera e së cilës do të përcaktohet nga KRPP-ja në legjislacionin dytësor. Dëshmia e pagesës duhet të bashkëngjitet vetë ankesës në përputhje me nenin 111 të këtij ligji. Pagesa do të bëhet në para të gatshme ose në ekuivalent të parave të gatshme në një llogari të hapur nga OSHP-ja në përputhje me Rregullat Financiare. 2. OSHP nuk do të pranojë ankesën nëse tarifa nuk paguhet*".

Kryesuesi i Sekretariatit, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - POLICIA E KOSOVËS**
- **OE - Astraplan SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: